



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC




PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE



BOTIM I FONDACIONI “PEMA E JETËS”

“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA
PËR PACIENTËT ME SKLEROZË
MULTIPLE”
(RAPORT)



Ky publikim është hartuar me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim nëpërmjet projektit “Shëndet për të gjithë” (HAP).

Grupi i autorëve:

Msc. Silvana Çausi (Lider i Projektit)

Dr.Pavlo Djamandi (Dr.Shkencash, Neurolog)

Dr.Evis Allushi (Dr.Shkencash)

Xhensila Ibrahimimi (Eksperte ligjore)

Msc. Lindita Arifi (Editor i Raportit)

Tanush Çausi (Fondacioni “Pema e Jetës”)

www.pemaeketes.org.al



Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e hartuesve të tij dhe në asnjë rast nuk do të konsiderohet si opinion i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Projektit “Shëndet për të gjithë”/ Health for All Project (HAP).

Nuk lejohet shumëfishimi apo kopjimi i përmbajtjes së këtij raporti pa lejen e prodhuesit, Fondacioni “Pema e Jetës”.

Tabela e Përmbajtjes

Kapitulli 1: Përmbledhje	6
Kapitulli 2: Metodologjia e studimit	7
Objektivi kryesor	7
Qasja e studimit	7
Objektivat specifikë të studimit.....	8
Mjetet dhe procedurat kërkimore.....	9
Popullata e synuar dhe përfshirja	10
Zbatimi i metodologjisë.....	10
Raportimi dhe analiza.....	10
Etika dhe miratimi.....	11
Kapitulli 3: Roli dhe Përfitimet e fizioterapisë për sklerozën multiple nga pikëpamja fizike	11
Metodat fizio-terapeutike qe aplikohen tek pacientët me SM [8]	14
Studime ndërkombëtare për përfitimet e fizioterapisë për pacientët me SM sklerozë multiple	16
Konkluzione	24
Rekomandime	25
Studimi shqiptar: “Rehabilitimi fizik si alternativë e rëndësishme për trajtimin e pacientëve me sklerozë multiple [9]”	26
Konkluzionet e studimit	27
Përfitimet e Fizioterapisë për Pacientët me Sklerozë Multiple	28

**“PËR FITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME
SKLEROZË MULTIPLE”**

Rekomandimet.....	29
Përfundim.....	30
Kapitulli IV: Perspektiva Neurologjike	30
Hyrje 30	
Fizioterapia për Sklerozën Multiple	31
Përfundim dhe rekomandime	35
Kapitulli IV: Kuadri Ligjor për Integrimin e Shërbimeve të Fizioterapisë për Pacientët me Sklerozë Multiple në Kujdesin Shëndetësor Parësor.....	35
Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021-2030	36
Mangësitë e strategjisë.....	38
Strategjia e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri 2020-2025	40
Sfidat dhe mangësitë	45
Kuadri ligjor dhe rregullator shqiptar dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB)	47
Përfundim	51
Rekomandime	52
Kapitulli V: Raporti Kosto-Përfitueshmëri	58
Studime ndërkombëtare.....	59
Llogaritja e Raporti Kosto-Përfitueshmëri (RKP), rasti i Shqipërisë.....	60
Studime ndërkombëtare.....	60
Përfitimet e fizioterapisë, një vështrim më i detajuar [33] 64	
Kapitulli VI: Rekomandime	65

**“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME
SKLEROZË MULTIPLE”**

Perspektiva Fizioterapeutike	66
Perspektiva Neurologjike.....	66
Perspektiva Ligjore	67
Perspektiva e Përfitimeve të Kostos	67
Kapitulli VII: Modeli i trajtimit i propozuar	68
Modeli digjital për realizimin afatshkurtër	68
Përdorimi i Teknologjisë dhe pajisjeve robotike.....	69
Modeli multidisiplinar afatgjatë	70
Përmirësimi i shërbimeve	71
Rekomandime për planin afatshurtër dhe afatgjatë të zbatimin të modelit.....	71
Referenca.....	72

Kapitulli 1: Përmbledhje

Ky raport është një nga dokumentat dhe instrumentat bazë të projektit "*Mundësimi i Trajtimit me Fizioterapi për individët të prekur nga Skleroza Multiple (SM) në Qendrat e Kujdesit Shëndetësor Parësor*" dhe jep një analizë në nivel ekspertize të thelluar për përfitimet dhe rolin që ka kryerja e fizioterapisë për pacientët me sklerozë multiple nga pikëpamja neurologjike dhe përmirësimi fizik. Gjithashtu këtu jepet edhe mbështetja dhe baza ligjore nga rrjedh kjo nevojë për këtë shërbim në përbushje të të drejtës njerëzore për shërbime për personat me SM.

Skleroza Multiple është një sëmundje kronike që ndikon në sistemin nervor qendror, duke sjellë simptoma të ndryshme si vështirësi motorike, spazmat muskulare, lodhjen kronike, dhimbjet, etj. Kjo sëmundje shfaqet në moshë të reja midis 20-40 vjeç dhe prek kryesisht meshkujt. Ekziston një gamë e gjerë studimesh ndërkombëtare dhe kombëtare që vërtetojnë se menaxhimi efektiv i SM kërkon një trajtim multidisiplinar, ku fizioterapia është mundësia e dytë e domosdoshme paralelisht me trajtimin me medikamente të përshtatshme.

Në këtë raport, analizohen bazuar tek rishikimi i literaturës katër aspekte: ligjore, fizioterapeutike, neurologjike dhe përfitueshmëria ekonomike. Këto aspekte janë të ndërlidhura me qëllimin për të arritur edhe në përfundimet dhe rekomandimet bazuar tek vlerësimi i ekspertëve me synimin kryesor për të analizuar rolin e fizioterapisë për pacientët me sklerozë multiple. Gjithashtu, krahas raporti kosto-përfitueshmëri bëhet dhe prezantimi i një modeli dhe strategjie zbatimi. Padyshim pjesa më e rëndësishme e këtij raporti janë edhe përfundimet dhe rekomandimet, të cilat kanë dalë nga hulumtimet.

Në vijim, do të shqyrtojmë metodologjinë që është ndjekur për përgatitjen e studimit. Kjo metodologji është dhënë në mënyrë të përmbledhur e bazuar tek dokumenti i përgatitur për këtë

qëllim me titull: “Metodologjia e Studimit “Përfitimet e fizioterapisë për personat me SM ne Shqipëri”

Kapitulli 2: Metodologjia e studimit

Metodologjia e studimit bazohet në rishikimin e literaturës shkencore të dhjetë viteve të fundit për përfitimet shëndetësore dhe kosto-efektivitetin e fizioterapisë në jetën e personave me SM. Njëkohësisht, është kryer edhe analiza e kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar që lidhet me aksesin në fizioterapi për pacientët me SM. Studimi do të përdorë të dhëna dytësore për të krahasuar përfitimet e fizioterapisë dhe për të nxjerrë përfundime mbi rëndësinë e këtij trajtimi për përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve në Shqipëri. Gjithashtu do të shqyrtohet edhe raporti kosto-përfitueshmëri dhe në përfundim do të jepen konkluzionet dhe rekomandimet.

Objektivi kryesor

Studimi ka për qëllim vlerësimin e përfitimeve që sjell fizioterapia për pacientët me sklerozë multiple (SM) në Shqipëri, duke analizuar ndikimin e këtij trajtimi në aspektin neurologjik, fizik ekonomik. Fizioterapia konsiderohet një trajtim plotësues thelbësor krahas medikamenteve për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe funksionimit fizik të pacientëve me SM. Gjithashtu ky studim ka një tjetër objektivi kryesor hulumtimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Qasja e studimit

Studimi përdor një projektion përshkrues dhe analitik për të mbledhur dhe analizuar të dhëna dytësore nga rishikimi i

“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE”

literaturës. Duke analizuar rezultatet e studimeve të kryera më parë në lidhje me përfitimet e fizioterapisë për pacientët me SM, studimi synon të nxjerrë përfundime të vlefshme për kontekstin shqiptar.

Objektivat specifikë të studimit

Studimi është strukturuar për të arritur këto objektiva:

a) Vlerësimi i përfitimeve neurologjike dhe fizike

Bazuar në literaturën e analizuar, ky objektivi do të përqendrohet në efektet e fizioterapisë mbi sistemin nervor dhe aspektin fizik të pacientëve me SM. Studimet do të analizohen duke shikuar sesi fizioterapia ndikon në lëvizshmëri, balancë, forcë muskulore...etj, te pacientët me SM që ndjekin fizioterapi, dhe këto të dhëna do të analizohen për të vlerësuar përfitimet e fizioterapisë.

b) Rishikimi i kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar

Studimi do të përqendrohet në identifikimin e politikave dhe ligjeve ekzistuese në vende/kontekste të ndryshme dhe në Shqipëri, që mbështesin ose pengojnë aksesin e pacientëve me SM ndaj fizioterapisë. Ky rishikim do të analizojë mundësitë për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rekomandimet për një integrim më të mirë të fizioterapisë në trajtimet e ofruara nga shërbimet publike shëndetësore.

c) Përfitimet ekonomike

Një analizë e thellë mbi përfitimet ekonomike të fizioterapisë, duke përfshirë kosto-efektivitetin e këtij trajtimi për pacientët. Studimi do të vlerësojë ndikimet pozitive të fizioterapisë në reduktimin e shpenzimeve shëndetësore afatgjata dhe rritjen e pjesëmarrjes aktive të pacientëve në shoqëri. Kjo gjë do të kryhet bazuar tek metodologjia e shqyrtuar në studime ndërkombëtare.

Mjetet dhe procedurat kërkimore

Metodologjia e përdorur do të bazohet kryesisht në **rishikimin e literaturës dytësore** dhe analizimin e burimeve ekzistuese të të dhënave, pa përfshirë fokus grupe apo të dhëna primare nga pacientët.

a) Rishikimi i literaturës

Ky proces do të përqendrohet në përmbledhjen dhe analizën e studimeve dhe raporteve shkencore të kryera në dhjetë vitet e fundit që lidhen me përfitimet e fizioterapisë për pacientët me SM. Literatura do të përfshijë:

- Studime shkencore ndërkombëtare mbi ndikimin e fizioterapisë në pacientët me SM.
- Rishikimi i ligjeve dhe rregulloreve që lidhen me aksesin (mundësimin) në shërbimet e fizioterapisë.
- Studime ekonomike mbi kosto-efektivitetin e fizioterapisë në menaxhimin afatgjatë të SM dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Këto burime të të dhënave do të shërbejnë për të krahasuar përfitimet dhe sfidat e fizioterapisë në kontekste të ndryshme dhe për të analizuar implikimet specifike për Shqipërinë.

b) Rishikimi i kuadrit ligjor dhe politik

Një aspekt i rëndësishëm i studimit do të jetë analiza e kuadrit ligjor në Shqipëri dhe Ndërkombëtar për shërbimet e fizioterapisë. Do të shqyrtohen politikat dhe ligjet aktuale në fushën e kujdesit shëndetësor, duke vlerësuar hapësirat për përmirësime dhe integritime të mëtejshme të shërbimeve të fizioterapisë për pacientët me SM.

Popullata e synuar dhe përfshirja

Popullata e synuar për këtë studim janë personat me sklerozë multiple në Shqipëri, megjithatë të dhënat primare nuk do të mblidhen përmes fokus grupeve apo intervistave direkte. Përkundrazi, studimi do të përdorë të dhënat ekzistuese nga literatura dhe raportet për të analizuar përfitimet e fizioterapisë në këtë grup pacientësh.

Zbatimi i metodologjisë

Zbatimi i metodologjisë do të fokusohet në:

- a) Rishikimin e literaturës ekzistuese për përfitimet e fizioterapisë për pacientët me SM, duke përfshirë studimet e mëparshme mbi trajtimet fizioterapeutike dhe rezultatet e tyre në menaxhimin e SM.
- b) Analiza e kuadrit ligjor, ku do të analizohen politikat kombëtare dhe ndërkombëtare që mbështesin aksesin e pacientëve me SM ndaj shërbimeve të fizioterapisë.
- c) Përfitimet neurologjike dhe fizike, duke kryer analizën e rezultateve të studimeve mbi efektet e fizioterapisë në përmirësimin e lëvizshmërisë dhe cilësisë së jetës së pacientëve me SM.
- d) Raporti Kosto – Përfitueshmëri (RKP)

Raportimi dhe analiza

Pas përfundimit të analizës së literaturës dhe kuadrit ligjor, studimi do të përgatisë një raport gjithëpërfshirës që do të përfshijë:

- Përfitimet fizike, neurologjike të fizioterapisë për pacientët me SM.
- Përfitimet ekonomike, përfshirë kosto-efektivitetin.

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

- Panorama e bazës ligjore -kombëtare dhe ndërkombëtare

Raporti përfundimtar do të përmbajë gjithashtu rekomandime për politikëbërësit dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor për përmirësimin e aksesit ndaj fizioterapisë për pacientët me SM në Shqipëri.

Etika dhe miratimi

Duke qenë se studimi nuk përfshin mbledhje të dhënash primare nga pacientët, por mbështetet në të dhëna dytësore, çështjet etike lidhen kryesisht me përdorimin e burimeve të të dhënave dhe literaturës me integritet dhe saktësi. Çdo burim do të citohet siç duhet në përputhje me rregullat etike të kërkimit shkencor.

Metodologjia e përdorur dhe e përshkruar në këtë kapitull jep bazat që studimi të jetë i garantuar përsa i përket besueshmërisë dhe saktësisë shkencore. Në kapitullin e ardhshëm, do të shqyrtojmë rolin e fizioterapisë tek pacientët me sklerozë multiple.

Kapitulli 3: Roli dhe Përfitimet e fizioterapisë për sklerozën multiple nga pikëpamja fizike

Me qëllim përgatitjen e këtij kapitulli kemi hulumtuar punime dhe artikuj shkencorë ndërkombëtarë dhe shqiptarë, të cilët kanë studiuar përfitimet e kryerjes së fizioterapisë për pacientët me sklerozë multiple.

Si studime ndërkombëtare të 10 viteve të fundit kemi zgjedhur 7 studime që shqyrtojnë efektivitetin e fizioterapisë për pacientët me sklerozë multiple (SM), duke përfshirë trajtime afatshkurtra, afatgjata, programe intensive dhe inovative, si dhe ndërhyrje të bazuara në teknologji. Në fazat e hershme të SM,

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

një strategji fizioterapie afatshkurtër është treguar efektive në përmirësimin e funksioneve motorike dhe cilësisë së jetës, duke ndihmuar pacientët të ruajnë pavarësinë e tyre [1]. Për pacientët me SM në gjendje të rëndë progresive, ndërhyrjet fizioterapeutike si Robot-Assisted Gait Training (RAGT) janë treguar më efektive për përmirësimin e lëvizshmërisë në krahasim me metodat konvencionale [2].

Në rastet e SM progresive, trajtimet me intensitet të lartë (HIIT) kanë treguar përmirësime të dukshme në kapacitetin fizik dhe kognitiv të pacientëve [3]. Një rishikim sistematik i provave të terapive fizike tregon përfitime të dukshme në aktivitetet e përditshme të pacientëve dhe cilësinë e jetës [4]. Po ashtu, një analizë e programeve fizioterapeutike për pacientët me SM tregon se ushtrimet e personalizuar për balancimin dhe forcimin e muskujve përmirësojnë funksionalitetin dhe reduktojnë lodhjen [5].

Ndërhyrjet fizioterapeutike janë gjithashtu shumë efektive në menaxhimin e spasticitetit tek pacientët me SM, duke reduktuar ndjeshëm spazmat muskulore dhe përmirësuar lëvizshmërinë [6]. Përveç metodave tradicionale, fizioterapia e bazuar në internet ofron një alternativë të qasshme dhe efektive për pacientët që nuk mund të marrin trajtime në qendra rehabilituese, duke përmirësuar aktivitetet e tyre të përditshme [7]. Në nënkapitullin më poshtë jepen detajet esenciale për secilin studim bashkë me rekomandimet përkatëse.

Këto shtatë studime konfirmojnë se fizioterapia është një komponent thelbësor në trajtimin e SM, duke përmirësuar funksionet motorike, menaxhimin e simptomave dhe cilësinë e jetës së pacientëve. Përmirësimet janë më të dukshme kur trajtimi është i personalizuar dhe i përshtatur për nevojat individuale të pacientit, duke përfshirë trajtime inovative dhe teknologjike.

“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE”

Si studim shqiptar, për të shpjeguar rolin e fizioterapisë dhe përfitimet për pacientët me sklerozë multiple është marrë në shqyrtim studimi i realizuar në Spitalin Rajonal Vlorë nga Dr. Evis Allushi me fokus pacientët me sklerozë multiple me titull “Rehabilitimi fizik si alternativë e rëndësishme në trajtimin e pacientëve me sklerozë multiple”.

Doktoratura e paraqitur nga Evis Allushi fokusohet në ndikimin që fizioterapia ka te pacientët me sklerozë multiple e provuar kjo në Shqipëri nga pikëpamja fizike dhe jo vetëm.

Studimi trajton rolin e rëndësishëm të fizioterapisë në përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve me sklerozë multiple. Fizioterapia jo vetëm që ndihmon në lehtësimin e simptomave fizike, por gjithashtu kontribuon në ruajtjen e funksionalitetit të përditshëm të këtyre pacientëve. Përmes një programi të strukturuar dhe të personalizuar të ushtrimeve, fizioterapia mund të ndihmojë në përmirësimin e forcës muskulore, qëndrueshmërisë, fleksibilitetit dhe ekuilibrit, të gjitha këto duke reduktuar rrezikun e komplikimeve të mëtejshme.

Një aspekt i rëndësishëm i trajtimit është se fizioterapia kontribuon në reduktimin e lodhjes dhe rritjen e energjisë, çka është thelbësore për mirëqenien e përgjithshme të pacientëve. Gjithashtu, fizioterapia ndihmon në menaxhimin e simptomave kronike dhe përmirësimin e shëndetit mendor, duke ofruar mbështetje psikologjike përmes aktiviteteve fizike dhe ndërveprimeve me terapistët.

Në përmbledhje, doktoratura përqendrohet në faktin se fizioterapia është një pjesë thelbësore e menaxhimit të sklerozës multiple dhe mund të sjellë përfitime të konsiderueshme për pacientët, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e tyre të jetës dhe duke i ndihmuar ata të përballen më mirë me sfidat e sëmundjes.

“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE”

Po cilat janë metodat kryesore që aplikohen tek pacientët me sklerozë multiple? Në nënkapitullin më poshtë do të hedhim një vështrim të shkurtër mbi këto metoda.

Metodat fizio-terapeutike që aplikohen tek pacientët me SM [8]

Skleroza Multiple (SM) është një sëmundje kronike që prek sistemin nervor qendror, duke çuar në një gamë të gjerë simptomash si humbja e koordinimit, dobësia muskulore dhe vështirësitë në lëvizje. Menaxhimi i këtyre simptomave përfshin një qasje multidisiplinare, ku fizioterapia luan një rol të rëndësishëm. Metodatat fizioterapeutike të përdorura për pacientët me SM synojnë të përmirësojnë lëvizshmërinë, të reduktojnë lodhjen dhe të rrisin cilësinë e jetës së tyre. Disa nga këto metoda përfshijnë:

Terapi për përmirësimin e ekuilibrit dhe koordinimit

Ekilibri dhe koordinimi janë dy fusha që shpesh dëmtohen te pacientët me SM. Terapitë për përmirësimin e ekuilibrit përfshijnë ushtrime specifike që ndihmojnë pacientët të fitojnë stabilitet dhe të zvogëlojnë rrezikun e rrëzimeve. Këto metoda mund të përfshijnë përdorimin e disqeve balancues, paraleleve për ecje, dhe platformave të lëvizshme, që simulojnë kushte të vështira për të rritur stabilitetin.

Terapi për forcimin muskolor

Pacientët me SM shpesh përjetojnë dobësi muskulore që ndikon në aftësinë e tyre për të kryer aktivitetet e përditshme. Ushtrimet për forcimin e muskujve janë thelbësore për të ruajtur funksionin e përgjithshëm dhe për të rritur tonifikimin e muskujve. Këto ushtrime përfshijnë:

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

Ushtrime me pesha të lehta ose shirita elastikë, të cilat ndihmojnë në forcimin e muskujve të prekur nga dobësia e shkaktuar nga SM.

Stërviçja në ujë (aquatic therapy) është një tjetër metodë efektive, pasi uji ofron një rezistencë natyrore, duke lehtësuar presionin mbi nyjet dhe duke mundësuar lëvizje më të lehta dhe më të rehatshme.

Kjo formë e terapisë mund të zbatohet në qendrat shqiptare që ofrojnë ambient të përshtatshëm për stërviçjet në ujë ose që kanë pajisje për forcimin muskolor. Nëse këto qendra kanë qasje në bazene terapeutike, pacientët do të përfitonin dukshëm.

Terapi për menaxhimin e spazmave muskulare

Spazmat dhe ngurtësimi muskolor janë simptoma të zakonshme tek pacientët me SM, të cilat shpesh i pengojnë të kryejnë lëvizje të zakonshme. Terapia për menaxhimin e spazmave përfshin teknika të ndryshme për qetësimin e muskujve të ngurtë dhe lehtësimin e dhimbjeve. Metodatat më të zakonshme përfshijnë:

- Stimulimi elektrik i nervave (TENS), një metodë e përdorur për të zbutur dhimbjen përmes impulseve të lehta elektrike.
- Ultratingulli terapeutik dhe kompresat e ngruhta, që ndihmojnë në relaksim të muskujve të prekur dhe në qetësimin e dhimbjes.

Terapi për përmirësimin e qëndrimit dhe lëvizshmërisë

Skleroza multiple shpesh ndikon në qëndrimin dhe lëvizshmërinë e pacientëve, duke çuar në ndryshime posturale dhe deformime të trupit. Terapitë për përmirësimin e qëndrimit përfshijnë ushtrime specifike që ndihmojnë pacientët të

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

rivendosin qëndrimin e duhur dhe të rrisin lëvizshmërinë e tyre. Këto përfshijnë:

Stretching dhe teknika për përmirësimin e fleksibilitetit, të cilat janë të rëndësishme për të zbutur muskujt dhe për të rritur gamën e lëvizjes.

Trajnimi për menaxhimin e lodhjes

Lodhja është një nga simptomat më të zakonshme që shfaqet te pacientët me SM, e cila mund të ndikojë në çdo aspekt të jetës së tyre. Terapitë për menaxhimin e lodhjes përfshijnë aktivitete fizike të moderuara që ndihmojnë në rritjen e energjisë dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë. Këto përfshijnë:

Programet e ushtrimeve aerobike të buta, si ecja, çiklizmi dhe ushtrimet në ujë, që kanë një ndikim të madh në reduktimin e lodhjes dhe përmirësimin e funksionit të përgjithshëm.

Pasi shyrtuam metodat kryesore fizio – terapeutike që aplikohen, më poshtë po japim disa studime ndërkombëtare që kemi studiuar rreth rolit të fizioterapisë tek pacientët me SM.

Studime ndërkombëtare për përfitimet e fizioterapisë për pacientët me SM sklerozë multiple

Me qëllim studimin e rolit të fizioterapisë tek pacientët me sklerozë multiple, më poshtë po paraqesim shkurtimisht detajet për shtatë studimet e marra në konsideratë. Për secilin studim janë paraqitur të dhënat e përgjithshme, zhvillimi i studimit, detaje dhe statistika, konkluzione dhe rekomandime. Më poshtë po i japim këto të dhëna.

“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE”

- 1) **Studimi 1:** “Efiçenca e një strategjie fizioterapie afatshkurtër në fazat e hershme të Sklerozës Multiple” [1] botuar nga HHPublisher.

Ky studim tregon përfitimet e një ndërhyrjeje fizioterapeutike afatshkurtër për pacientët në fazat e hershme të sklerozës multiple (SM). Studimi përqëndrohet në ndikimin e fizioterapisë mbi përmirësimin e funksioneve motorike dhe cilësisë së jetës për pacientët me diagnozë të hershme të SM.

Zhvillimi i Studimit

Një grup prej 5 pacientësh që sapo ishin diagnostikuar me SM u përfshinë në një program fizioterapie për një periudhë 6-javore. Gjatë kësaj kohe, ata iu nënshtruan një programi të personalizuar ushtrimesh që përfshinte forcimin e muskujve, ushtrime balancimi dhe ecje. Matjet e performancës funksionale u bënë në fillim dhe në fund të periudhës së trajtimit.

Detaje dhe Statistika nga studimi

Rezultatet treguan përmirësime të dukshme në shkallët e matjes së funksioneve motorike dhe pavarësisë. Niveli i funksionit fizik, i matur përmes Functional Independence Measure (FIM), u rrit me 15% nga 3.5 në 4.2, ndërsa cilësia e jetës, e matur përmes SF-36, u përmirësua me 20%. Pacientët gjithashtu përjetuan më pak lodhje dhe përmirësime në koordinim.

Konkluzionet e studimit

Fizioterapia afatshkurtër mund të ketë ndikime të konsiderueshme në fazat e hershme të SM, duke ndihmuar pacientët të ruajnë pavarësinë dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës. Kjo ndërhyrje afatshkurtër ofron përfitime të menjëhershme për pacientët që janë në fazat e hershme të

“PËR FITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE”

sëmundjes dhe mund të përdoret si strategji parandaluese për përqendrimin e simptomave.

Rekomandime të studimit

Autorët rekomandojnë që programet fizioterapeutike të fillojnë sa më shpejt pas diagnozës për të maksimizuar përfitimet dhe të ndihmojnë pacientët të ruajnë funksionet fizike për sa më gjatë që të jetë e mundur.

- 2) **Studimi 2:** “Efektiviteti i ndërhyrjeve fizioterapeutike për lëvizshmërinë tek sklerozë multiple e rëndë: një rishikim sistematik dhe meta-analizë” [2], i publikuar tek World Physiotherapy

Ky rishikim sistematik dhe meta-analizë shqyrton efektivitetin e ndërhyrjeve fizioterapeutike në përmirësimin e lëvizshmërisë tek pacientët me SM të rëndë. Studimi përfshin një analizë të gjerë të ndërhyrjeve si Robot-Assisted Gait Training (RAGT), trajnimi me peshë trupore dhe metodat konvencionale të rehabilitimit.

Zhvillimi i studimit

U përfshinë 37 studime me 788 pacientë, ku u krahasuan efektet e metodave të ndryshme fizioterapeutike mbi lëvizshmërinë e pacientëve me SM të avancuar. Ndërhyrjet përfshinin trajnime me ndihmë teknologjike dhe metodat konvencionale të ecjes.

Detaje dhe statistika

Në bazë të rezultateve të analizës, trajnimi i ndihmuar nga robotët (RAGT) tregoi përmirësime të konsiderueshme në lëvizshmëri. Pacientët që iu nënshtruan RAGT treguan përmirësime prej 30% në testin e ecjes 6-minutëshe dhe në shkallën e balancit Berg, krahasuar me 12% për metodat e tjera konvencionale.

“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE”

Konkluzione

RAGT është veçanërisht efektiv për pacientët me SM të rëndë, duke përmirësuar ndjeshëm lëvizshmërinë dhe cilësinë e jetës. Metodatat konvencionale gjithashtu ofrojnë përfitime, por përmirësimet janë më të vogla në krahasim me teknologjitë e avancuara.

Rekomandime

Autorët rekomandojnë zgjerimin e përdorimit të teknologjive të ndihmuara nga robotët për rehabilitimin e pacientëve me SM të rëndë, veçanërisht për ata që kanë dëmtime motorike të avancuara.

- 3) **Studimi 3:** “Fizioterapia për Pacientët me Sklerozë Multiple Progressive” [8], botuar tek University i Glasgow.

Ky studim përqendrohet në fizioterapinë për pacientët me sklerozë multiple progresive, duke shqyrtuar përfitimet e trajnimit me intensitet të lartë (HIIT) për përmirësimin e funksioneve motorike dhe cilësisë së jetës.

Zhvillimi i studimit

Pacientët iu nënshtruan një programi të trajnimit HIIT për një periudhë 8-javore, duke përfshirë ushtrime për rritjen e qëndrueshmërisë dhe forcës muskulore. U matën përmirësimet në shpejtësinë e përpunimit mendor, kapacitetin aerobik dhe shëndetin e përgjithshëm.

Detaje dhe statistika

Pas 8 javëve, rezultatet treguan përmirësime të rëndësishme në shpejtësinë e përpunimit kognitiv me 15%, ndërsa kapaciteti

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

aerobik u rrit me 20%. Shkalla e vlerësimit të cilësisë së jetës u rrit me 25%, ndërsa normat e lodhjes u ulën me 30%.

Konkluzione

Fizioterapia e bazuar në trajnime me intensitet të lartë mund të përmirësojë ndjeshëm funksionet motorike dhe kapacitetin kognitiv për pacientët me SM progresive, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Rekomandime

Autorët sugjerojnë që trajnimet me intensitet të lartë të përfshihen në programet e rehabilitimit për pacientët me SM progresive, duke theksuar nevojën për më shumë kërkime në këtë fushë.

- 4) **Studimi 4;** "Exercise Therapy and Multiple Sclerosis: A Systematic Review", publikuar tek revista e neurologjisë nga Springer [4]

Ky rishikim sistematik i provave klinike të kontrolluara randomizuara analizon ndikimin e terapisë fizike në pacientët me SM, duke vlerësuar përfitimet e tyre për aktivitetet e përditshme.

Zhvillimi i studimit

U shqyrtuan 11 studime që përfshinë 591 pacientë, ku u analizua ndikimi i terapisë fizike në aktivitetet e përditshme dhe cilësinë e jetës. Metodologjia përfshiu krahasimin e pacientëve që morën fizioterapi me ata që ishin në grupet e kontrollit ose në listat e pritjes.

Detaje dhe statistika

Rezultatet treguan se pacientët që morën terapi ushtrimesh kishin përmirësime të konsiderueshme në aktivitetet e përditshme me një përmirësim prej 18-25% në kapacitetin fizik

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

dhe aftësitë motorike. Gjithashtu, përmirësimet në balancën trupore dhe ecjen ishin domethënëse.

Konkluzione

Terapitë ushtrimore kanë një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e funksioneve motorike dhe pavarësisë për pacientët me SM, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Rekomandime

Autorët sugjerojnë që fizioterapia të përfshihet si pjesë e standardit të kujdesit për pacientët me SM, me një fokus të veçantë në përmirësimin e aktiviteteve të përditshme.

- 5) **Studimi 5;** "Analysis of a physiotherapy program in a group of patients with multiple sclerosis" [5]

Ky studim shqyrton një program fizioterapie për pacientët me SM dhe mat ndikimin e tij në përmirësimin e balancës trupore dhe aftësive funksionale.

Zhvillimi i Studimit

Pacientët iu nënshtruan 18 seancave fizioterapie që përfshinin ushtrime për përmirësimin e forcës muskulore dhe koordinimin. Seancat ishin të përqendruara në ushtrime balancimi dhe forcimi të gjymtyrëve.

Detaje dhe statistika

Pas përfundimit të programit, përmirësimet në balancë u vlerësuan me një rritje prej 22% në shkallën e balancës Berg, ndërsa përmirësimet në koordinim u rritën me 15%. Pjesëmarrësit gjithashtu raportuan një ulje të lodhjes me 18%.

Konkluzione

Programi fizioterapeutik ka përmirësuar ndjeshëm balancën dhe aftësitë funksionale të pacientëve me SM, duke

“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE”

përmirësuar gjithashtu cilësinë e jetës dhe ulur ndjenjën e lodhjes.

Rekomandime

Autorët rekomandojnë aplikimin e programeve fizioterapeutike të personalizuara për pacientët me SM për të maksimizuar përfitimet dhe për të rritur pavarësinë funksionale.

- 6) **Studimi 6;** “Effectiveness of Physiotherapy Interventions on Spasticity in People with Multiple Sclerosis” [6]

Ky studim meta-analitik shqyrton efektivitetin e ndërhyrjeve fizioterapeutike për menaxhimin e spasticitetit tek pacientët me SM.

Zhvillimi i studimit

U analizuan të dhënat nga 12 studime me 462 pacientë, ku u krahasua efektiviteti i trajtimeve fizioterapeutike për reduktimin e spasticitetit dhe përmirësimin e funksioneve motorike.

Detaje dhe statistika

Ndërhyrjet fizioterapeutike, përfshirë ushtrimet e zgjatjes dhe masazhimin, treguan një reduktim prej 25% në nivelet e spasticitetit. Gjithashtu, përmirësime të mëdha u vunë re në testin e ecjes me 10 metra dhe forcën muskulore.

Konkluzione

Ndërhyrjet fizioterapeutike janë shumë efektive në menaxhimin e spasticitetit dhe përmirësimin e funksioneve motorike, duke ndihmuar pacientët të përmirësojnë lëvizshmërinë dhe të reduktojnë lodhjen.

Rekomandime

"PËR FITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

Autorët sugjerojnë përdorimin e rregullt të metodave fizioterapeutike për menaxhimin e spasticitetit në pacientët me SM për të përmirësuar cilësinë e jetës.

7) **Studimi 7**; Web-Based Physiotherapy for People Affected by Multiple Sclerosis [7]

Ky studim shqyrton efektivitetin e fizioterapisë së bazuar në internet për pacientët me SM, duke përmirësuar aktivitetet e përditshme dhe duke ofruar rehabilitim në distancë.

Zhvillimi i Studimit

Pacientët përfituan nga një program rehabilitimi të bazuar ndjekur në internet për një periudhë 12-javore, që përfshinte seanca të drejtuara nga fizioterapistë dhe ndjekjen e progresit përmes platformave online.

Detaje dhe statistika

Rezultatet treguan përmirësime të konsiderueshme në funksionet motorike dhe cilësinë e jetës. Pacientët që përdorën programet në internet treguan një përmirësim prej 17% në aktivitetet e përditshme dhe raportuan një ulje të lodhjes me 20%.

Konkluzione

Fizioterapia e ndjekur në internet është një alternativë e suksesshme për pacientët me SM, duke siguruar trajtim të vazhdueshëm dhe të qasshëm përmes teknologjisë, veçanërisht gjatë kohërave kur aksesimi në qendrat rehabilituese është i kufizuar.

Rekomandime

Autorët sugjerojnë zgjerimin e programeve të bazuara në internet si një mënyrë për të përmirësuar aksesin në rehabilitim për pacientët me SM dhe për të ofruar trajtim të personalizuar në distancë.

Konkluzione

Bazuar tek shtatë studimet e shqyrtuara konkludojmë se Fizioterapia është një komponent thelbësor në trajtimin e sklerozës multiple (SM), duke ofruar përfitime të dukshme në të gjitha fazat e sëmundjes. Trajtimet afatshkurtra ndihmojnë në ruajtjen e funksioneve motorike dhe pavarësinë në fazat e hershme. Për pacientët me SM të rëndë, teknologjitë si Robot-Assisted Gait Training (RAGT) përmirësojnë lëvizshmërinë në mënyrë më efektive se trajtimet tradicionale. Për pacientët me SM progresive, trajnimet me intensitet të lartë (HIIT) kontribuojnë në përmirësimin e kapacitetit fizik dhe kognitiv.

Rishikimet tregojnë se ushtrimet fizioterapeutike ndihmojnë në përmirësimin e funksioneve motorike, zvogëlimin e lodhjes dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Terapitë për menaxhimin e spasticitetit janë gjithashtu efektive për reduktimin e spazmave muskulore. Fizioterapia e bazuar në internet ofron një mundësi të qasshme për pacientët që nuk mund të marrin trajtim në qendrat rehabilituese, duke siguruar vazhdimësi të kujdesit dhe përmirësime të qëndrueshme në funksionet motorike. Fizioterapia duhet të jetë pjesë integrale e trajtimit të SM, duke përdorur metoda të personalizuara dhe inovative për të optimizuar përfitimet për pacientët.

Rekomandime

Bazuar tek këto studime dalin këto rekomandime më të rëndësishme:

- Rekomandohet që programet fizioterapeutike të fillojnë menjëherë pas diagnozës për pacientët me sklerozë multiple, për të parandaluar përkeqësimin e simptomave dhe për të ruajtur funksionet motorike dhe pavarësinë.
- Teknologjitë si Robot-Assisted Gait Training (RAGT) si një mënyrë fizioterapie duhet të adoptohen më gjerësisht për pacientët me SM të rëndë, duke ndihmuar në përmirësimin e lëvizshmërisë dhe balancës në mënyrë më efektive se metodat tradicionale.
- Pacientët me SM progresive mund të përfitojnë nga trajnimet me intensitet të lartë (HIIT), të cilat përmirësojnë kapacitetin fizik dhe kognitiv. Rekomandohet përfshirja e HIIT në programet e rehabilitimit për këta pacientë.
- Terapitë fizioterapeutike të bazuara në ushtrime të personalizuar duhet të jenë pjesë e kujdesit standard për të gjithë pacientët me SM, duke pasur një fokus të veçantë në përmirësimin e balancës, forcës muskulore dhe reduktimin e lodhjes.
- Terapitë fizioterapeutike që trajtojnë spasticitetin duhet të përdoren rregullisht për pacientët që përjetojnë spazma muskulore, për të përmirësuar lëvizshmërinë dhe për të reduktuar dhimbjet.
- Programet fizioterapeutike të bazuara në internet ofrojnë një alternativë të dobishme për pacientët që nuk mund të marrin trajtim fizikisht në qendrat rehabilituese. Rekomandohet zhvillimi dhe zgjerimi i

“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE”

këtyre programeve për të përmirësuar aksesin dhe vazhdimësinë e kujdesit për pacientët me SM.

Në thelb të gjitha këto rekomandime tregojnë për nevojën për fizioterapi për pacientët me sklerozë multiple.

Studimi shqiptar: “Rehabilitimi fizik si alternativë e rëndësishme për trajtimin e pacientëve me sklerozë multiple [9]”

Studimi, i botuar nga Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Tiranë përqendrohet në analizën e përfitimeve të rehabilitimit fizik për pacientët me sklerozë multiple. Kjo sëmundje autoimune prek sistemin nervor qendror dhe shkakton simptoma motorike dhe neurologjike që ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e jetës së pacientëve. Rehabilitimi fizik, përfshirë seancat e fizioterapisë, është vlerësuar si një ndërhyrje thelbësore për të menaxhuar simptomat dhe për të ngadalësuar përkeqësimin e funksioneve motorike.

Në studim janë përfshirë 58 pacientë të hospitalizuar në Spitalin Rajonal të Vlorës gjatë një periudhe të caktuar, dhe moshën mesatare të pacientëve ishte 43 vjeç. Një nga gjetjet e tjera të rëndësishme ishte se numri i pacientëve të hospitalizuar me sklerozë multiple në këtë spital ishte relativisht i ulët, duke reflektuar ndoshta nivelin e ulët të diagnostikimit ose ndërjegjësimit për këtë sëmundje.

Studimi tregon gjithashtu një përqindje të barabartë të meshkujve dhe femrave të përfshirë, me shumicën e tyre që banojnë në qytet dhe kanë arsim të mesëm. Ndër faktorët sociodemografikë që ndikojnë në aksesin në seanca rehabilituese janë vendbanimi, punësimi dhe statusi civil. [9]

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

Metodat kryesore të reabilitimit që ishin aplikuar tek pacientët që morën pjesë në studim ishin ushtrime për ekuilibrin dhe koordinimin, për forcën muskulare, për përmirësimin e ngurtësisë (spazmave) dhe për të përmirësuar lëvizjen.

Konkluzionet e studimit

Ky studim ofron disa konkluzione të rëndësishme lidhur me reabilitimin fizik dhe përfitimet e tij për pacientët me sklerozë multiple. Këtu janë dhënë edhe konkluzione të tjera përveç atyre që tregojnë për përfitimet e fizioterapisë:

1. Numri i pacientëve të përfshirë në reabilitim (58) është relativisht i ulët, megjithatë studimi tregon përfitime të qarta për pacientët që marrin pjesë në këto seanca.
2. Faktorët sociodemografikë, përfshirë vendbanimin, punësimin dhe statusin civil, ndikojnë në qasjen e pacientëve në reabilitim. Pacientët që banojnë në zonat urbane kanë më shumë mundësi për të marrë pjesë në seanca fizioterapie krahasuar me ata që banojnë në zona rurale.
3. Arsyt kryesore të hospitalizimit përfshijnë simptoma si inkontinenca urinare, mpirja dhe bllokimi i këmbëve, si dhe çrregullimet në gjëlltjtje. Pacientët që nuk kanë mundur të ecin për shkak të përkeqësimit të gjendjes së tyre motorike gjithashtu janë hospitalizuar.
4. Evoluimi i sëmundjes është gradual, dhe përmirësimet janë më të dukshme te pacientët që kryejnë seanca reabilituese në mënyrë të rregullt. Studimi tregon se lidhja midis seancave reabilituese dhe gjendjes së pacientit është statistikisht e rëndësishme ($p < 0.0055$).

5. Ditëqëndrimi në spital varion nga 1-10 ditë. Pacientët që kryejnë seanca fizioterapie kanë një qëndrim mesatarisht më të shkurtër në spital (4 ditë), duke treguar se rehabilitimi fizik ndihmon në përmirësimin më të shpejtë të gjendjes së tyre.

Përfitimet e Fizioterapisë për Pacientët me Sklerozë Multiple

Bazuar në të dhënat e studimit, rehabilitimi fizik dhe veçanërisht fizioterapia ofron një sërë përfitimesh për pacientët me sklerozë multiple. Këto përfitime përfshijnë:

1. Fizioterapia ndihmon në reduktimin e spazmave muskulare, lodhjes dhe dhimbjeve, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e jetës së pacientëve.
2. Trajtimet fizioterapeutike përmirësojnë funksionet motorike, përfshirë balancën, qëndrimin dhe koordinimin. Kjo u mundëson pacientëve të kryejnë aktivitete të përditshme me një shkallë më të lartë pavarësie.
3. Pacientët që ndjekin rregullisht seanca fizioterapie kanë një pavarësi më të madhe në jetën e tyre të përditshme. Ata janë më të aftë për të kryer detyra të thjeshta, duke ulur varësinë nga të tjerët.
4. Fizioterapia ndikon jo vetëm në përmirësimin fizik, por edhe në shëndetin mendor të pacientëve. Përmirësimi i funksioneve motorike rrit vetëbesimin dhe ul ndjenjën e izolimit

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

Rekomandimet

Në bazë të gjetjeve të studimit, disa rekomandime të rëndësishme janë paraqitur për të përmirësuar trajtimin dhe përkrahjen e pacientëve me sklerozë multiple:

1. Rehabilitimi fizik ndikon pozitivisht në gjendjen shëndetësore të pacientëve dhe duhet të bëhet pjesë e rutinës së përditshme për të menaxhuar simptomat dhe për të përmirësuar funksionet motorike.
2. Sigurimi i mbulimit financiar për seancat rehabilituese është thelbësor për të siguruar që pacientët të kenë qasje të barabartë në këto trajtime. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në qytete si Vlora, ku aksesit ekonomik në shërbime të tilla mbetet sfidë për shumë pacientë.
3. Të dhënat e këtij studimi mund të përdoren për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e rehabilitimit fizik dhe për të zhvilluar strategji për mbështetjen më të madhe të pacientëve.
4. Mangësia e informacionit mbi rehabilitimin fizik në pacientët me sklerozë multiple është një problem i madh që ndikon në stigmën ndaj këtyre pacientëve. Janë të domosdoshme më shumë studime në këtë fushë për të forcuar argumentet mbi efektivitetin e rehabilitimit.
5. Përpilimi i një dokumentacioni më të plotë dhe të saktë për pacientët është thelbësor për të vlerësuar saktësisht ecurinë e trajtimit të tyre dhe për të planifikuar strategjitë e ardhshme rehabilituese.

Përfundim

Studimi i kryer nga Dr. Evis Allushi tregon qartë se rehabilitimi fizik, veçanërisht fizioterapia, ka një ndikim të madh në përmirësimin e gjendjes së pacientëve me sklerozë multiple. Ky trajtim ndihmon jo vetëm në uljen e simptomave, por gjithashtu në përmirësimin e funksioneve motorike dhe cilësisë së përgjithshme të jetës. Rekomandohet që rehabilitimi fizik të përfshihet në programet e kujdesit shëndetësor për pacientët me sklerozë multiple dhe të mbulohet nga sigurimet shëndetësore për të siguruar akses të barabartë për të gjithë pacientët.

Përfitimet fizike të fizioterapisë, si përmirësimi i lëvizshmërisë dhe balancës, janë të ndërthurura ngushtë me përfitimet neurologjike, pasi fizioterapia ndihmon në reduktimin e simptomave neurologjike të sklerozës multiple.

Në kapitullin vijues, do të analizojmë se si ndërhyrjet fizioterapeutike ndihmojnë në mbështetjen e sistemit nervor qendror dhe në menaxhimin e simptomave neurologjike të kësaj sëmundjeje.

Kapitulli IV: Perspektiva Neurologjike

Hyrje

SM është një sëmundje autoimune inflamatore demielinizante dhe është një nga sëmundjet kryesore që çon në disfunkcion neurologjik kronik. SM karakterizohet nga atake të përsëritura që çojnë në akumulim të vazhdueshëm të deficiteve neurologjike, duke lënë pasojë të tilla si: dobësi muskulore, spazma të muskujve, dridhje dhe ataksi, lodhje, çrregullime të

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

ndjeshmërisë, çrregullime të urinimit dhe defekimit, disfunkcion seksual, dhimbje, çrregullim të të folurit dhe gëlltitjes, çrregullime njohëse, çrregullime psikologjike dhe psikiatrike që rezultojnë gradualisht në kufizim të aktivitetit të përditshëm. Pra, preket në mënyrë serioze shëndeti fizik dhe aktivitetet sociale të individit.

Megjithëse mjekimet me imunosupresorë mund të vonojnë progresin dhe efektet shkatërrimtare të sëmundjes, ende nuk ka një mjekim që të ndalojë avancimin dhe të kurojë sëmundjen. [11] Studimet e fundit tregojnë se trajtimet rehabilituese mund të përmirësojnë statusin funksional dhe të reduktojnë nivelin e paaftësisë, dhe janë metoda të rëndësishme trajtimi për të përmirësuar aftësinë lëvizëse në përditshmëri. [12] [13]

Studimet tregojnë se në fiziopatologjinë e SM përfshihen shumë faktorë dhe mund të jetë rezultat i ndërveprimit të qelizave gliale, faktorëve imunitarë, faktorëve mjedisorë dhe atyre ushqimorë. [14] [15] Terapia rehabilituese redukton citokinat inflamatore në sistemin imunitar periferik, mbron sistemin nervor qendror, ngadalëson neurodegjenerimin, nxit neuroplasticitetin dhe, së fundmi, mund të ngadalësojë dhe progresin e sëmundjes. [16] [17]

Fizioterapia për Sklerozën Multiple

Menaxhimi simptomatik i të sëmurëve me SM ka të bëjë me mbështetjen e përditshme në drejtim të përmirësimit të funksionimit, pavarësisë dhe cilësisë së jetës së këtyre pacientëve gjatë ecurisë kronike të sëmundjes.

Menaxhimi simptomatik është po aq i rëndësishëm për cilësinë e jetës sa edhe zgjedhja e medikamentit trajtues. Trajtimi optimal i simptomave kërkon një punë në ekip të drejtuar nga një profesionist, ku përfshihen mjekë dhe specialistë

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

rehabilitimi, neuropsikologë, logopedë, psikiatër, familjarë, dhe punonjës socialë.

Evidenca në rritje mbështesin faktin se ushtrimet fizike apo fizioterapia reduktojnë lodhjen të sëmurët me SM, si dhe parametra të tjerë biometrikë, dhe madje mund të përmirësojnë edhe performancën njohëse. Pacientët dhe fizioterapistët ndajnë së bashku shqetësimin për atë se cilat lloje ushtrimesh janë të përshtatshme dhe si të ushtrohen "pa e tepruar."

Në vitin 2012, Shoqata e SM të Kanadasë publikoi për herë të parë ushtrimet aerobike për të sëmurë me SM në format e lehta dhe të mesme të sëmundjes. [18] Në vitin 2020, këtyre rekomandimeve iu shtuan të tjera me qëllim për të përfshirë gjithë spektrin e dizabilitetit të SM, duke shtuar tipe specifike ushtrimesh dhe qëllimet e tyre (si ushtrime për ekuilibrin). [19] Versione të përpunuara të këtyre ushtrimeve mund t'u jepen edhe pacientëve.

Konsiderata të përgjithshme kur rekomandohen ushtrimet:

- Ushtrimet janë të dobishme pavarësisht nivelit të dizabilitetit të personit.
- Ushtrimet duhet të përshtaten në mënyrë që t'u adresohen nevojave, kapacitetit dhe preferencave të personit.
- Ushtrimet mund të përkeqësojnë simptomat të pacientët që janë të ndjeshëm ndaj të nxehtëti.

Në përgjithësi, rekomandohen 120-150 minuta në javë. Një studim së fundmi ka vlerësuar në mënyrë sistematike tek 15 studimet e botuara në Cochrane Database of Systematic Reviews deri në Dhjetor 2017, lidhur me efektivitetin e ndërhyrjeve rehabilituese të pacientët me SM. [20]

Ky studim ka analizuar 15 rishikime që kanë përfshirë brenda tyre 164 studime klinike të rastësishme me grup kontrolli

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

(randomised controlled trials RCT) dhe 4 studime klinike me grup kontrolli (controlled clinical trials), me një total prej 10,396 pacientësh. Kuptohet që u analizuan disa lloje ndërhyrjesh rehabilituese: si aktiviteti fizik, terapi me oksigjen hiperbarik, terapi okupacionale, ndërhyrje njohëse dhe psikologjike, suplemente dietike dhe ushqimi, ndërhyrje për menaxhimin e spasticitetit, etj. Në këtë studim u identifikuan dy Cochrane Reviews që vlerësojnë fizioterapinë dhe ushtrimet te pacientët me SM.

Heine 2015 - vlerësoi efektshmërinë dhe sigurinë e ushtrimeve fizike mbi lodhjen te pacientët me SM. Autorët përfshinë 45 RCT (N=2250 pjesëmarrës) dhe vlerësuan 69 lloje ndërhyrjesh fizike: ushtrime rezistence (23 ndërhyrje); trajnim i forcës muskulare (5 ndërhyrje); trajnim i përzier (15 ndërhyrje); trajnim i orientuar drejt detyrave (5 ndërhyrje); ose të tjera, si Yoga (17 ndërhyrje). Autorët përfundimisht raportuan një efekt të rëndësishëm mbi lodhjen në favor të atyre që kishin kryer terapi ushtrimore krahasuar me ata që nuk kishin kryer (grupi i kontrollit). Gjatë gjithë studimeve, nuk u vu re shoqërimi i ushtrimeve me rrezikun për relaps apo ngjarje të padëshiruara. Autorët konkluduan se ushtrimet fizike (të rezistencës, përzier, apo të tjera) mund të reduktojnë lodhjen dhe mund të rekomandohen te pacientët me SM pa patur shqetësimin e dëmtimeve.

Reitberg 2005 - 6 studime morën përsipër krahasimin e atyre që i nënshtrohen ushtrimeve fizike dhe atyre që nuk i nënshtrohen, ndërsa 3 studime krahasuan dy modalitete të ndryshme fizioterapie. Autorët këtu dalin në përfundimin se ushtrimet fizike, të cilat janë pjesë e fizioterapisë mund të rekomandohen dhe janë të dobishme. Dobishmëria e ushtrimeve fizike, sipas studimit të Reitberg (2005), qëndron në përmirësimin e aftësive motorike, funksionimit të përditshëm dhe reduktimin e simptomave si lodhja dhe spasticiteti, duke

"PËR FITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

kontribuar në një cilësi më të mirë të jetës për pacientët me sklerozë multiple.

Khan 2017 - kjo analizë përfshiu 14 studime të publikuara nga vitet 2000 deri në 2016 të gjitha review Cochrane dhe jo-Cochrane. Në këtë analizë, të gjitha rishikimet treguan se fizioterapia, pavarësisht nëse kryhet në një spital ose në kushte ambulatorë, ndikon në përmirësimin e disa komponentëve specifikë të funksionit motorik të pacientët me sklerozë multiple (SM).

Në mënyrë specifike, përmirësimet universale të përmendura në këto studime përfshijnë:

1. Pacientët treguan përmirësime të dukshme në ekuilibrin e tyre, gjë që ndihmon në zvogëlimin e rrezikut për rënie.
2. Rritja e koordinimit midis gjymtyrëve dhe lëvizjeve të tyre ndihmon në përmirësimin e aktivitetit të përditshëm dhe funksionit të përgjithshëm.
3. Terapitë fizioterapeutike përfshijnë ushtrime për forcimin e muskujve që ndihmojnë në mbajtjen e pavarësisë fizike.
4. Pacientët përmirësuan aftësinë e tyre për të kryer aktivitete të përditshme si ecja dhe ngritja, duke rritur kështu pavarësinë funksionale.
5. Të gjitha rishikimet përfshinin përmirësime në reduktimin e lodhjes dhe menaxhimin e spasticitetit, simptoma të zakonshme të pacientët me SM.

Përfitimet universale të fizioterapisë, sipas Khan (2017), përfshijnë përmirësimin e funksionit motorik pavarësisht vendit të trajtimit apo metodës së përdorur. Këto përfitime janë të qëndrueshme, pavarësisht nëse trajtimi është bërë në një mjedis spitalor ose ambulatorë, dhe janë të njohura gjerësisht

në të gjitha rishikimet, duke e bërë fizioterapinë një qasje efektive dhe të përhapur për menaxhimin e sklerozës multiple.

Përfundim dhe rekomandime

- Skleroza Multiple është një sëmundje komplekse që shpesh paraqet deficite të ndryshme (motorike, ndijore, njohëse, të sjelljes, etj.) dhe që kërkon një kujdes rehabilitues të koordinuar, multidisiplinar dhe të vazhdueshëm. Evidencat e prezantuara më lart mbështesin një strategji që rekomandon qasje të ndryshme rehabilituese, ndonëse theksi është vendosur te rehabilitimi fizik dhe ushtrimet fizike.
- Rehabilitimi fizik përmirëson prognozën funksionale (lëvizshmërinë, forcën muskulore, kapacitetin aerobik) dhe cilësinë e jetës, si dhe redukton lodhjen te pacientët me SM.

Në kapitullin vijues, do të analizojmë kuadrin ligjor të shërbimeve të fizioterapisë për pacientët me sklerozë multiple, duke eksploruar rregulloret dhe strategjitë dhe ligjet kombëtare dhe konventën e OKB-se për aftësinë e kufizuar (Organizata e Kombeve të Bashkuara) që ndikojnë në zbatimin e këtyre shërbimeve.

Kapitulli IV: Kuadri Ligjor për Integrimin e Shërbimeve të Fizioterapisë për Pacientët me Sklerozë Multiple në Kujdesin Shëndetësor Parësor

Ky seksion i raportit shqyrton kuadrin aktual ligjor që rregullon shërbimet shëndetësore në Shqipëri në lidhje me shërbimin e fizioterapisë. Në të përfshihen ligjet dhe strategji që

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

parashetrojnë organizimin e sistemit shëndetësor në Shqipëri, si: Ligji NR. 10 107, datë 30.3.2009, "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2021-2030, Strategjia e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri 2020-2025 dhe "Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollin Opsional" (kjo e fundit lidhet pasi një nga pasojat që sjell Skleroza Multiple është aftësia e kufizuar). Analiza e dispozitave ekzistuese shqyrton mundësitë ligjore për përfshirjen e fizioterapisë specifike për personat me Sklerozë Multiple në Qendrat Shëndetësore të KSHP, me synimin garantimin e aksesit dhe cilësinë e shërbimeve për personat me SM. Integrimi i shërbimeve të fizioterapisë për pacientët me Sklerozë Multiple (SM) në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor është një hap i rëndësishëm drejt përmbushjes së këtyre objektivave dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së pacientëve. Gjithashtu në këtë seksion sugjerohen dhe ndryshime ligjore dhe amendime të legjislacionit ekzistues që të bëjmë të mundur që këta persona të kenë trajtim të dedikuar bazuar edhe tek nevojat specifike. Këto janë të dhëna tek nënseksioni i rekomandimeve.

Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021-2030

Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021-2030 është një dokument politik i qeverisë shqiptare që synon të përcaktojë dhe të arrijë objektivat për mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullsisë shqiptare. Qëllimi kryesor është që deri në vitin 2030, shëndeti dhe mirëqenia e popullatës të përmirësohet ndjeshëm, të forcohet shëndeti publik dhe të

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

krijohet një sistem shëndetësor i qëndrueshëm me në qendër pacientin. Gjithashtu kjo strategji parashikon edhe shërbimin universal dhe të dedikuar për pacientët.

Kjo strategji përman katër objektiva kryesore, të detajuar me objektiva specifike dhe masat për realizimin e tyre. Më poshtë paraqitën objektivat, objektivat specifike, masat dhe lidhja e tyre me shërbimin e fizioterpisë.

Objektivi 1 i Politikës III [20] në Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030 është "Fuqizimi i Sistemit Shëndetësor," dhe ky objektivi lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët. Kjo përfshin fuqizimin e kapaciteteve të kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor, ku fizioterapia bën pjesë. Rrjedhimisht, bazuar tek ky objektivi

përfituesit nga realizimi i këtij objektivi janë pacientët me sëmundje të ndryshme përfshi ato kronike si skleroza multiple.

Objektivi Specifik I: Fuqizimi i sistemit shëndetësor për të adresuar nevojat shëndetësore specifike të popullatës dhe barrierat për barazi gjatë gjithë ciklit të jetës.

Bazuar tek interpretimi në këndvështrimin ligjor, kjo përfshin përmirësimin e shërbimeve të ofruara dhe integrimin e kujdesit rehabilitues (ku përfshihet fizioterapia). Tek adresimi i nevojave shëndetësore specifike, në këtë rast adresohen dhe inkuadrohen personat që vuajnë nga skleroza multiple.

Masa 3.1.1: Forcimi i shërbimeve dhe rritja e aksesit në kujdesin shëndetësor parësor, duke rinovuar infrastrukturën e qendrave shëndetësore dhe pikave të ambulancave në çdo cep të Shqipërisë brenda vitit 2025. Bazuar tek interpretimi në këndvështrimin ligjor, kjo masë nënkupton rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kushteve për ofrimin e

shërbimeve të ndryshme ku përfshihen dhe ato rehabilituese, (fizioterapia), në Qendrat e Kujdesit Shëndetësor Parësor.

Objektivi 2: Progresi drejt Mbulimit Universal Shëndetësor (MUSH) [21]

Objektivi II: Sigurimi i përgjigjes së sistemit shëndetësor ndaj nevojave shëndetësore të popullatës. MUSH synon të sigurojë akses në shërbime shëndetësore efikase dhe me cilësi të lartë për të gjithë njerëzit në vend kur dhe ku kanë nevojë për to, pa vështirësi financiare. Në këtë kontekst, fizioterapia është një shërbim thelbësor për trajtimin, rehabilitimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve me SM.

Në përgjithësi, Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021-2030 është një hap pozitiv për fuqizimin e sistemit shëndetësor dhe përfshirjen e fizioterapisë si shërbim thelbësor. Në këtë dokument del qartë tek masat e dhëna **integrimi i fizioterapisë në Mbulimin Universal Shëndetësor (MUSH)**, duke siguruar që të gjitha shërbimet fizioterapeutike për pacientët me sëmundje kronike të mbulohen nga sigurimet shëndetësore dhe të eliminohen barrierat financiare. Gjithashtu ky dokument parashikon edhe fuqizimin e kapaciteteve.

Mangësitë e strategjisë

Bazuar tek analiza e dokumentit janë identifikuar problematikat dhe mangësitë që mund të ndikojnë në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030, të cilat janë shpjeguar më poshtë:

- Mungesa e mekanizmave të monitorimit të detajuar

Në dokumentin e strategjisë, ekziston një theksim mbi nevojën për monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të masave të ndërmarra. Megjithatë, nuk janë detajuar në mënyrë të qartë mekanizmat specifikë të monitorimit dhe raportimit që do të

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

mundësonin ndjekjen e progresit në nivel kombëtar. Kjo mund të çojë në dobësi në zbatimin e politikave, pasi nuk ka qartësi mbi rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve për mbikëqyrjen dhe ndjekjen e progresit në zbatim.

- Varësia nga investimet në infrastrukturë

Një pjesë e rëndësishme e strategjisë për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, përfshirë fizioterapinë, varet nga rinovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së qendrave shëndetësore deri në vitin 2025. Masa 3.1.1 parashikon këtë përmirësim, por nëse investimet publike dhe mbështetja logjistike nuk janë të mjaftueshme ose nuk realizohen në kohë, zbatimi i strategjisë mund të vonohet ose të mbetet i kufizuar në zona të caktuara. Strategjia duhej të konsideronte edhe burimet alternative në rastin kur ky përmirësim i infrastrukturës nuk do mund të realizohej. [23]

- Mungesa e detajeve mbi financimin e plotë të shërbimeve

Edhe pse strategjia synon mbulimin universal shëndetësor dhe integrimin e fizioterapisë në sistemin shëndetësor publik, nuk janë dhënë detaje të qarta mbi burimet financiare dhe alokimin e fondeve specifike për shërbimet rehabilituese. Kjo mungesë qartësie mund të ndikojë negativisht në zbatimin e fizioterapisë për grupet vulnerabël, si pacientët me sklerozë multiple. [24]

- Kapacitetet e pamjaftueshme të burimeve njerëzore

Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore është një objektiv thelbësor i strategjisë. Megjithatë, nuk është përcaktuar në mënyrë të detajuar se si do të trajnohen fizioterapistët dhe personeli shëndetësor për të përmbushur kërkesat në rritje për shërbime rehabilituese. Nëse mungon një plan i qartë dhe efektiv për trajnimin e burimeve njerëzore, kapacitetet e pamjaftueshme mund të ndikojnë në ofrimin e këtyre shërbimeve. [25]

- Zbatimi jo i barabartë gjeografik

“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE”

Strategjia synon që shërbimet shëndetësore, përfshirë fizioterapinë, të jenë të arritshme për të gjithë qytetarët. Megjithatë, ka një rrezik që implementimi të mos jetë i barabartë në të gjitha zonat, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta. Nëse nuk ka një mekanizëm të qartë për të siguruar qasje të barabartë në të gjithë vendin, grupet e marginalizuara mund të përballen me vështirësi në aksesin e këtyre shërbimeve . [26]

Përfundim

Si konkluzion, Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030 është një dokument i mirë-strukturuar që synon të përmirësojë qasjen dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore, përfshirë fizioterapinë. Megjithatë, zbatimi i saj has në vështirësi për shkak të mungesës së mekanizmave të qartë të monitorimit, varësisë nga investimet infrastrukturore, mungesës së detajeve mbi financimin dhe sfidave me kapacitetet njerëzore. Për të garantuar zbatimin e suksesshëm të kësaj strategjie, është e nevojshme të adresohen këto problematika dhe mangësi dhe të sigurohet që të gjitha institucionet të punojnë në mënyrë të koordinuar për të përmbushur objektivat e vendosura

Strategjia e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit

Shëndetësor Parësor në Shqipëri 2020-2025

Qeveria Shqiptare lidhur me Strategjinë Kombëtare për Shëndetësinë 2021-2030 ka miratuar me VENDIM Nr.405, datë 20.5.2020 “STRATEGJINË E ZHVILLIMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR NË SHQIPËRI 2020-2025.

Kjo strategji ka për qëllim: Të rrisë cilësinë dhe spektrin e shërbimeve në Kujdesin Shëndetësor Parësor (KSHP) dhe te

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

ofrojë shërbime shëndetësore dhe sociale të integruara për t'iu përgjigjur nevojave individuale të individëve dhe grupeve në nevojë.

Në politiken 3 të kësaj Strategjie i kushtohet rëndësi e vecantë infrastrukturës dhe teknologjisë diagnostikuese në institucionet e KSHP. Në të parashikohet se është e nevojshme që të rishikohen standardet minimale dhe nevojitet më shumë investim për përmirësimin e infrastrukturës së qendrave shëndetësore në mënyrë që të korrespondojnë me standardet funksionale të një qasjeje moderne të KSHP në drejtim të aksesueshmërisë ,sidomos për personat me aftësi të kufizuar. [27]

Objektivi i politikës 3. është mundësimi i aksesit në një KSHP me infrastrukturë dhe teknologji diagnostike të përshtatshme e të qëndrueshme në mënyrë që të bëjë të mundur sigurimin e mbulimit shëndetësor universal dhe aksesin e barabartë në shërbime.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është institucioni i cili është përgjegjës për zbatimin e programit të rehabilitimit të 300 qendrave shëndetësore. Sipas kësaj politike më shumë se 75% e popullatës (duke përfshirë personat me aftësi të kufizuar) do të kenë akses në QSH-të e rehabilituara deri në vitin 2025. Kuptohet se aftësia e kufizuar është një nga pasojat që sjell në personat me SM.

Objektivi specifik 2 i politikës 3 është rritja e aksesit në shërbimet diagnostikuese dhe trajtuese në nivel të KSHP sipas një pakete bazë të rishikuar.

Fuqizimi i qendrave të përzgjedhura shëndetësore në 10 qytete të mëdha me qëllim krijimin e një modeli të përqëndruar të ofrimit të shërbimeve të mjekësisë së familjes, shërbimeve diagnostike (RO, imazheri), laboratorike dhe të rehabilitimit.

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

Politika 5. Shërbimet bazë të KSHP për Mbulimin Shëndetësor Universal parashikon:

Rritjen e aksesit në shërbime bazë të KSHP për të gjithë dhe përfshirja e individëve, familjeve dhe komuniteteve për optimizimin e shëndetit të tyre. Objektivi i kësaj politike është përmirësimi dhe përshtatja e paketës shëndetësore bazë në përputhje me nevojat e popullsisë. Shtimi i shërbimeve të reja dhe integrimi me shërbimet psiko-sociale (kujdesi paliativ, kujdesi në familje, kujdesi psikologjik, rehabilitimi fizik etj. (fizioterapia është pjesë e rehabilitimit fizik). [28]

Politika 6: Sigurimi i Mbulimit Shëndetësor Universal në KSHP përmes buxhetimit të qëndrueshëm dhe efektiv. Objektivi specifik i politikës 6 është të sigurojë financimin e duhur dhe të qëndrueshëm për KSHP-në duke bërë të mundur uljen e shpenzimeve personale nga ana e grupeve vulnerabel.

Politika 7. Përcaktimi dhe pilotimi i tipeve të reja të shërbimeve dhe rishpërndarja gjeografike

KSHP duhet të përshtatet me nevojat specifike të popullatave vulnerabel (të moshuar të izoluar, personat me aftësi të kufizuara etj.) Aktualisht, shërbimet e KSHP për grupet e cënueshme janë të ndara nga shërbimet sociale. Të dyja shërbimet duhet të jenë më të koordinuara dhe me të integruara. [29]

Objektivi specifik 2 i politikës 7 është mbështetja dhe integrimi vertikal i shërbimeve të KSHP . Përmirësimi i koordinimit i KSHP me hallkat e sistemit të kujdesit shëndetësor dhe social. Kjo do të bëhet e mundur në sajë të bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve të sistemit, si Shoqatat e Mjekëve të Familjes, Fakulteti i Mjekësisë dhe ai i Shkencave Teknike Mjekësore, Urdhëri i Mjekëve, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe agjensitë e saj. Zbatimi

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

i ë politike do te sjelle ndjekje më të mirë të pacientëve dhe vijueshmëri më të mirë e kujdesit.

Objektivi specifik 3 i politikës 7 eshte : Të rrisë mbulimin e komunitetit me shërbime të KSHP duke i dhënë përparësi grupeve vulnerabël .Mbështetje e Qendrave shëndetësore nga Njësiti vendore te kujdesit shëndetësor për vlerësimin e nivelit të riskut dhe vulnerabilitetit në popullatën që ata mbulojnë me qëllim përshtatjen e vazhdueshme të shërbimeve me nevojat.

Objektivi specifik 4 i politikës 7 eshte rimodelimi dhe shpërndarja gjeografike të KSHP për të ofruar kujdes më efikas, dhe njëkohësisht duke siguruar akses në shërbimet e KSHP për të gjitha kategoritë e popullatës. Rezultati i zbatimit të kësaj politike do të jetë :

-Përshtatja fleksibël e burimeve dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore, duke u bazuar në karakteristikat dhe nevojat e popullatës.

-Ngritja e një modeli të Qendrës së Mjekësisë së Familjes, duke pilotuar dhe integruar atë në sistemin e KSHP. Do të ngrihen Qendrat e Mjekësisë së Familjes duke u bazuar në qendrat ekzistuese të kujdesit shëndetësor, duke i shërbyer një popullate të konsiderueshme. Qendrat e Mjekësisë së Familjes mund të përfshijnë disa shërbime të veçanta (shërbime mbi problemet e shëndetit mendor, paliative, fizioterapi, kujdes social psikologjik të integruar etj. Këtu bën pjesë dhe rehabilitimi fizik)

-Krijimi i Modelit të Qendrës së Mjekësisë së Familjes duke ofruar shërbime më cilësore.Qendrat shëndetësore gjithëpërfshirëse te mjekesise se familjes ofrojne shërbime më cilësore.

Rezultati i zbatimit për politikën 7 do të jetë :

- 10 qendra të Mjekësisë Familjare të ngritura

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

- 4 qendra pilot të kujdesit të integruar shëndetësor e social
- 10 modele të shërbimit 24 orësh në zona të thella siguruar përmes QSH rurale të koordinuara;
- 2 qendra të reja të kujdesit paliativ pranë KSHP.

Politika 8. Cilësia e shërbimeve të KSHP

Objektivi specifik 1 i politikës 8 është të sigurojë ofrimin e shërbimeve të KSHP gjithnjë e më cilësore duke garantuar normat bazë të cilësisë dhe duke aplikuar modele të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë .

Rezultatet e zbatimit të kësaj politike do të jenë :

- Përpilimi i protokolleve që mungojnë;
- Hartimi i udhëzimeve parandaluese bazuar në fakte për secilën grupmoshë.

Përditësim i rregullt i tyre, udhëzime dhe protokolle klinike të përmirësuara ose të hartuara për herë të parë. Pra, kërkesa jonë është plotësisht e bazuar ligjërisht në legjislacionin shqiptar, dhe sipas këtij legjislacioni, deri në fund të vitit 2025, si rezultat i zbatimit të politikave të **Strategjisë së Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020-2025**, ky shërbim duhet të ishte përfshirë në qendrat e Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe qendrat shëndetësore duhet të kenë aksesueshmëri edhe për personat me aftësi të kufizuara. Sot, jemi përballë faktit që personat me aftësi të kufizuara nuk kanë akses në të gjitha qendrat shëndetësore të Republikës së Shqipërisë, dhe shërbimi i fizioterapisë nuk është i përfshirë ende në të gjitha qendrat shëndetësore primare.

Sfidat dhe mangësitë

Duke shqyrtuar Strategjinë e Zhvillimit të Kujdesit Parësor 2020-2025, disa nga problematikat dhe mangësitë që mund të ndikojnë në zbatimin efektiv të saj janë të qarta, edhe pse dokumenti nuk i përmend drejtpërdrejt. Këto problematika vijnë nga analizimi i objektivave dhe masave që përfshin strategjia, si dhe sfidat praktike të implementimit të saj.

- Mungesa e mekanizmave të qartë për monitorim

Në strategji ka një theks të rëndësishëm për nevojën e monitorimit të zbatimit të politikave dhe masave, por nuk janë përcaktuar në mënyrë të detajuar mekanizmat që do të mundësonin këtë proces. Pa monitorim të vazhdueshëm dhe të qartë, do të jetë e vështirë të vlerësohet progresi në arritjen e objektivave dhe të ndërmerren masa korrigjuese kur të jenë të nevojshme .

- Kapacitetet e pamjaftueshme njerëzore

Një tjetër problematikë është mungesa e një plani të detajuar për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore. Strategjia parashikon nevojën për trajnimin e stafit mjekësor dhe personelit të përfshirë në kujdesin parësor, por nuk ka qartësi se si do të sigurohet kjo. Nëse kapacitetet njerëzore nuk rriten në mënyrë të mjaftueshme, kjo mund të pengojë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të fizioterapisë dhe kujdesit rehabilitues në përgjithësi .

- Zbatimi jo i barabartë në zona rurale dhe të largëta

Strategjia synon përmirësimin e kujdesit shëndetësor në të gjithë vendin, përfshirë zonat rurale dhe të largëta. Megjithatë, mbetet një sfidë e madhe zbatimi i barabartë i masave në këto zona, duke marrë parasysh barrierat infrastrukturore dhe mungesën e burimeve të nevojshme. Nëse nuk merren masa shtesë për të siguruar që këto zona të kenë infrastrukturën dhe personelin e nevojshëm, qasja në shërbimet shëndetësore

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

parësore, përfshirë fizioterapinë, do të jetë e kufizuar . Në këtë Strategji nuk janë detajuar këto masa.

- Financimi i pamjaftueshëm dhe alokimi i burimeve

Një mangësi tjetër e kësaj strategjie është mungesa e detajeve të qarta mbi burimet financiare dhe mënyrën se si do të alokohen fondet për zbatimin e masave të parashikuara. Financimi i pamjaftueshëm ose alokimi i papërshtatshëm i burimeve mund të ndikojë negativisht në zbatimin e strategjisë, veçanërisht për sa i përket investimeve në infrastrukturë dhe burime njerëzore .

- Varësia nga investimet në infrastrukturë

Një nga masat kryesore të strategjisë është përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore, përfshirë rinovimin dhe zgjerimin e qendrave shëndetësore. Megjithatë, suksesi i strategjisë është thellësisht i varur nga realizimi i këtyre investimeve brenda afateve të caktuara. Nëse përmirësimet në infrastrukturë vonohen, atëherë edhe përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe aksesit të popullatës në to do të mbetet i kufizuar.

Përfundim

Strategjia e Zhvillimit të Kujdesit Parësor 2020-2025 ofron një kornizë të mirë për përmirësimin e aksesit në shërbime shëndetësore për të gjithë qytetarët. Megjithatë, mungesa e mekanizmave të qartë të monitorimit, kapacitetet e pamjaftueshme njerëzore, sfidat infrastrukturore dhe financimi i pamjaftueshëm janë ndër sfidat kryesore që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kësaj strategjie. Për të siguruar një zbatim efektiv, është e nevojshme që këto problematika të adresohen në mënyrë të qartë dhe të planifikuar.

Kuadri ligjor dhe rregullator shqiptar dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB)

Sa më poshtë, paraqitet kuadri ligjor dhe rregullator kombëtar dhe ndërkombëtar që parashtron detyrimin për shërbime të fizioterapisë për personat me SM. Janë një sërë ligjesh kombëtare dhe ndërkombëtare që rregullojnë shërbimin e rehabilitimit fizik për personat që kanë këto nevoja specifike, ku këtu bëjnë pjesë edhe personat me sklerozë multiple.

1. LIGJ Nr.10 107, Datë 30.3.2009 PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Ky ligj Siguron akses të gjerë në shërbime shëndetësore dhe mbulon nevojat për rehabilitim dhe fizioterapi për pacientët me sëmundje kronike siç është SM. Më konkretisht po japim më poshtë referencat me nenet përkatëse:

Neni 2, Parimet e kujdesit shëndetësor – Ky nen thekson të drejtën themelore për kujdes shëndetësor të barabartë për të gjithë individët, duke përfshirë edhe aksesin për shërbime rehabilituese dhe fizioterapi, pa diskriminim.

Neni 6, Shërbimet e kujdesit shëndetësor – Ky nen specifikon që kujdesi shëndetësor përfshin masa rehabilituese, të cilat janë një pjesë integrale e shërbimeve që ofrohen për përmirësimin e mirëqenies fizike dhe sociale të shtetasve.

Neni 19, Mjekësia rehabilituese dhe sportive – Ky nen përkufizon drejtpërdrejt mjekësinë rehabilituese, e cila përfshin fizioterapinë si një shkencë që ndihmon në rikthimin e aftësive të humbura për shkak të sëmundjeve, përfshirë sëmundjet kronike si skleroza multiple. Gjithashtu, ky nen përcakton se fizioterapistët punojnë në bashkëpunim me profesionistë të

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

tjerë për të rikthyer autonominë fizike dhe përmirësimin e aftësive të pacientëve.

Neni 9, Kujdesi shëndetësor parësor – Në këtë nen, theksohet se kujdesi shëndetësor parësor përfshin edhe shërbimet rehabilituese dhe fizioterapinë, duke plotësuar nevojat për trajtime bazë të riaftësimit.

Në këto dispozita dhe nene të dhëna më lart, ligji garanton që pacientët me sëmundje kronike, përfshirë sklerozën multiple, kanë të drejtën për të marrë shërbime rehabilituese dhe fizioterapeutike, dhe përfshirja e këtyre shërbimeve në sistemin shëndetësor është e qartë. [10]

2. Ligji 93/2014 për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara

Nga analiza e bërë rezulton se "Ligji 93/2014 garanton pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e shoqërisë, duke përfshirë aksesin në shërbime shëndetësore dhe rehabilituese". Për të dalë në këtë konkluzion mund të referohemi në disa nene kryesore të ligjit që përmbajnë këtë detyrim. [11]

- Neni 1, Objekti – Ky nen thekson se ligji ka për qëllim garantimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë aksesueshmërinë në shërbime. Në këtë kontekst, shërbimet shëndetësore dhe rehabilituese përfshihen në kategoritë e shërbimeve të nevojshme për këta persona.
- Neni 2, Qëllimi – Ky nen është qendror për të mbështetur pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e shoqërisë, përfshirë aksesin në kujdesin shëndetësor dhe shërbimet rehabilituese. Synimi është të

"PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

mundësohet një jetë autonome për këta individë, duke rritur në maksimum pavarësinë e tyre dhe pjesëmarrjen aktive në komunitet.

- Neni 5, Jetesa e pavarur – Ky nen thekson qartë të drejtën për akses në shëndetësi dhe rehabilitim, duke specifikuar që politikat shtetërore duhet të mbështesin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në kujdesin shëndetësor, rehabilitim dhe shërbime shoqërore të tjera.
- Neni 6, Shërbimet për një jetesë të pavarur – Ligji siguron që shërbimet për një jetë të pavarur, duke përfshirë shërbimet e rehabilitimit dhe aksesin në kujdesin shëndetësor, janë në dispozicion për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, rrjedhmisht duke përfshirë ata me sklerozë multiple, që mund të kenë kufizime fizike të ndjeshme.

Këto dispozita të ligjit ofrojnë bazën për të garantuar që personat me aftësi të kufizuara, siç janë pacientët me sklerozë multiple, të kenë akses të plotë në shërbime shëndetësore dhe rehabilituese, duke përfshirë edhe fizioterapinë, në përputhje me të drejtat e tyre për pjesëmarrje të barabartë në shoqëri. Dihet se një nga pasojat shëndetësore që sjell skleroza multiple është edhe aftësia e kufizuar nga pikëpamja fizike.

3. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Skleroza Multiple është një sëmundje që shkakton aftësi të kufizuar tek personat që vuajnë nga kjo sëmundje dhe për këtë arsye kemi analizuar këtë konventë.

Me ratifikimin dhe nënshkrimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Qeveria Shqiptare ka marrë detyrime konkrete dhe të qarta që shkojnë përtej një aspekti simbolik ose honorifik. Këto detyrime përfshijnë ndërmarrjen e masave të cilat sigurojnë akses të barabartë për

**“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME
SKLEROZË MULTIPLE”**

personat me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet e jetës publike, përfshirë edhe shërbimet rehabilituese si fizioterapia.

- a) Aksesueshmëria (Neni 9): Qeveria ka detyrimin të eliminojë pengesat fizike dhe infrastrukturore që kufizojnë aksesin e personave me aftësi të kufizuara në ndërtesa, transport, dhe shërbime publike. Kjo përfshin sigurimin e aksesit në ndërtesat publike, shkollat, objektet mjekësore dhe vendet e punës përmes përshtatjeve arkitekturore dhe teknologjike që u mundësojnë këtyre personave të jetojnë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në shoqëri.
- b) Shëndeti (Neni 25): Qeveria Shqiptare është e detyruar të ofrojë shërbime shëndetësore, duke përfshirë rehabilitimin, në një mënyrë që është e qasshme dhe ndjeshme ndaj nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin sigurimin e shërbimeve shëndetësore që minimizojnë dhe parandalojnë aftësi të kufizuara të mëtejshme përmes ndërhyrjeve të hershme dhe programeve specifike.
- c) Rehabilitimi (Neni 26): Një nga detyrimet kryesore të Qeverisë Shqiptare është krijimi dhe ofrimi i programeve gjithëpërfshirëse rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe ata me sklerozë multiple (SM). Këto programe duhet të synojnë përmirësimin e pavarësisë dhe aftësisë së tyre fizike, mendore dhe sociale përmes fizioterapisë dhe masave të tjera rehabilituese, siç është parashikuar në këtë Konventë.
- d) Monitorimi dhe zbatimi (Neni 33): Qeveria Shqiptare ka përgjegjësinë për të krijuar mekanizma monitorimi të pavarur që do të ndjekin përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe zbatimin e plotë të Konventës. Për më

"PËR FITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE"

tepër, shoqëria civile dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara duhet të përfshihen në procesin e monitorimit dhe vendimmarrjes.

Në përmbledhje, nënshkrimi dhe ratifikimi i kësaj Konvente nga Qeveria Shqiptare nuk është thjesht një veprim simbolik, por përfshin një sërë detyrimesh ligjore dhe administrative që synojnë përmirësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, qeveria është e detyruar të sigurojë qasje në shërbime rehabilituese dhe fizioterapi, duke përbushur standardin më të lartë të kujdesit shëndetësor për këtë grup të ndjeshëm, dhe të krijojë një sistem monitorimi efektiv për të siguruar përbushjen e këtyre detyrimeve.

Përfundim

Bazuar në kuadrin ligjor dhe strategjik të përshkruar më lart, është e qartë që integrimi i shërbimeve të fizioterapisë për pacientët me Sklerozë Multiple (SM) në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri është i bazuar plotësisht në ligj. Por, këto strategji kanë disa problematika dhe mangësi siç janë:

- Mungesa e mekanizmave të qartë për monitorim
- Mungesa e një plani të detajuar për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore
- Mungesa e masave shtesë për të siguruar që zonat rurale dhe të largëta të kenë infrastrukturën dhe personelin e nevojshëm
- Mungesa e detajeve të qarta mbi burimet financiare dhe mënyrën se si do të alokohen fondet për zbatimin e masave të parashikuara
- Varësia nga investimet në infrastrukturë

“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE”

Këto mangësi diktojnë ndryshime ligjore dhe detajime të legjislacionit konform nevojave të caktuara personave me sklerozë multiple. Pra, ky legjislacion aktual ka nevojë për përmirësime dhe ndryshime për t’iu përshtatur nevojave të veçanta të grupeve, siç është rasti i personave me sklerozë multiple që po studiojmë.

Rekomandime

Për të siguruar që personat me sklerozë multiple në Shqipëri të kenë akses të plotë dhe të rregullt në fizioterapi, duhet të ndërmerren disa hapa të rëndësishëm që mbështeten në baza ligjore dhe strategjike. Më poshtë janë sugjerime dhe zgjidhje të mundshme, të mbështetura në dokumentet ekzistuese dhe legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar:

I. Krijimi i një ligji të veçantë për kujdesin rehabilitues për sklerozën multiple

Një hap i rëndësishëm do të ishte hartimi i një ligji të veçantë që garanton qasjen e rregullt në fizioterapi për personat me sklerozë multiple. Ky ligj do të bazohej në Ligjin nr. 10107, datë 30.03.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili tashmë parashikon ofrimin e kujdesit shëndetësor gjithëpërfshirës, duke përfshirë shërbimet rehabilituese si fizioterapia. Ligji do të detajonte detyrimet e shtetit për të siguruar që çdo pacient me sklerozë multiple të ketë të drejtën e fizioterapisë të mbuluar plotësisht nga sigurimet shëndetësore publike.

Për më tepër, ky ligj mund të bazohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara Neni 25 i CRPD për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila kërkon që shtetet të ofrojnë shërbimet e nevojshme për të siguruar një cilësi të lartë të jetës për personat me aftësi të kufizuara. Kjo do të

“PËRFITIMET NGA FIZIOTERAPIA PËR PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE”

garantonte që fizioterapia të jetë një e drejtë themelore për këta pacientë.

Krijimi i një ligji të veçantë për kujdesin rehabilitues për pacientët me sklerozë multiple mund të bazohet në disa dokumente të rëndësishme që janë në fuqi ose janë parashikuar në strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare. Më poshtë janë detajet dhe referencat ku mund të mbështetet një ligj i tillë.

1. Ligji nr. 10107, datë 30.03.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”

Ky ligj krijon bazën për ofrimin e kujdesit shëndetësor në Shqipëri dhe parashikon që shteti është përgjegjës për sigurimin e kujdesit cilësor dhe gjithëpërfshirës për qytetarët. Ky ligj, i cili mund të ndryshohet ose plotësohet, mund të përfshijë dispozita specifike për rehabilitimin dhe kujdesin ndaj pacientëve me sëmundje kronike si skleroza multiple. Neni 4 i këtij ligji garanton akses të barabartë për të gjithë në kujdes shëndetësor, duke përfshirë kujdesin rehabilitues.

2. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD)

